



**IN. THE DOOR**  
Në Shërbim të komunitetit të Shkodrës

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA SHËRBIMEVE**  
**SOCIALE, STREHIMIT DHE**  
**SHËNDETIT PUBLIK**

**SHOQATA THE DOOR**

Nr. 14107 Prot  
Shkodër, më 31.08.2018

Nr. 153 Prot  
Shkodër, më 31.08.2018

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

E lidhur sot në Bashkinë Shkodër, me datë 31/08/2018 ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

**Bashkia Shkodër**, me adresë: rruga 13 Dhjetori, nr 1, përfaqësuar nga Kryetarja e Bashkisë Shkodër **Znj. Voltana Ademi**, këtë e tutje e cilësuar si **Bashkia**


*dhe*

Shoqatës **“The Door”** me adresë: Lgj. Naim Gjylbegu, Rr. Bujar Bishanaku, regjistruar si person juridik, më datë 01.12.2015, me nr. Vendimi 153, NIPT K46823026U, përfaqësuar nga Z. Kastriot Faci, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Shoqatës **OJF The Door”**.

**NENI 1**  
**Objekti**

Objekt i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi të ndërsjella në zbatimin e ndërhyrjeve që synojnë forcimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, fuqizimit dhe mbështetjes së familjeve në vështirësi social – ekonomike me synim integrimin e fëmijëve në sistemin edukativ mes pushtetit lokal Bashkisë Shkodër dhe OJF The Door.

Me anë të kësaj Marrëveshje synohet bashkëpunimi në mbështetjen dhe integrimin e fëmijëve në edukimin parashkollor si një e drejtë kushtetuese, duke ofruar shanse të barabarta për arsimim, mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve në mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre.





Palët do të zbatojnë ndërhyrjet e përbashkëta në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe të udhëhequr nga parimi i “**interesit më të lartë të fëmijës**”, duke iu referuar standarteve të shtetit shqiptar.

## **NENI II**

### **Baza ligjore**

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Ligji Nr. 121/2016, Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë, Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimpruse” i ndryshuar, Ligji 69/2012 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, V.K.M nr. 658 datë 17.10.2005 “Për standartet e shërbimeve shoqërore”, Ligji nr. 10071, datë 09.02.2009 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”.

## **NENI III**

### **Qëllimi**

Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe OJF “The Door”, në zbatimin e programit të bashkëpunimit me qëllim ofrimin e shërbimeve integrale dhe edukuese për fëmijët e familjeve vulnerabël dhe në vështirësi socio-ekonomike, pranë ambjenteve të ish- shkollës Veterinare.

## **NENI IV**

### **Rolet dhe përgjegjësitë e OJF The Door**

1. The Door ofron shërbime mbështetëse dhe integrale për fëmijët dhe familjet në vështirësi socio-ekonomike.
2. The Door garanton mbështetje financiare për 3 punonjës; 2 Punonjëse (1 sanitare dhe 1 ndihmëse kuzhinierë), dhe një roje kopështi.
3. The Door mbështet fëmijët me ushqim për dy vakte; mëngjes dhe drekë.
4. The Door angazhohet të paraqesë pranë Bashkisë Shkodër raport të shkruar në mënyrë periodike, (cdo 6 muaj mbi ecurinë e aktiviteteve të Qendrës objekt i kësaj marrëveshjeje, arritjet dhe problematikat e hasura dhe të dhëna statistikore mbi numrin e përfituesve të shërbimeve të ofruara gjatë kësaj periudhe.
5. Të bashkërendojë dhe të koordinojë me Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Strehimit





dhe Shëndetit Publik, planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

## NENI V

### Rolet dhe përgjegjësitë e Bashkisë Shkodër

#### **Bashkia Shkodër merr përsipër këto angazhime:**

1. Në kuadër të ofrimit të forcimit të shërbimeve për fëmijët dhe familjet në vështirësi social-ekonomike:
  - 1.1 Të koordinojë shërbimet për fëmijët dhe familjet me qendrën komunitare “Për Familjen” nr. 1 dhe 2 dhe organizatën The Door.
  - 1.2 Të sigurojë ambjentet e duhura dhe të përshtatshme, për realizimin e veprimtarive të Kopshtit pranë ish- shkollës Veterinare.
  - 1.3 Bashkia e Shkodrës do të vazhdojë të sigurojë pagesën e personelit prej 2 Edukatore, si pjesë e shërbimeve të edukimit parashkollor. Personeli do të jetë në funksion të aktiviteteve të Kopshtit dhe aktiviteteve ekstrakurrikulare, rekreative të Kopshtit.
  - 1.4 Bashkia e Shkodrës do të kryejë pagesën e kostove operative; energji elektrike, ujë dhe ngrohje.
  - 1.5 Bashkia e Shkodrës merr përsipër që personeli i Bashkisë duhet të zbatojë me përpikmëri Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.
  - 1.6 Të bashkërendojë me The Door, përmes vlerësimit të nevojave në komunitet për hartimin e një plani të përbashkët për të siguruar koordimin dhe vazhdimësinë e shërbimeve për integrimin e fëmijëve dhe fuqizimin e familjeve.
2. Bashkia Shkodër do të lehtësojë procedurat dhe ndarjen e përgjegjësisë për mbështetjen siç parashikohet nga ligji në lidhje me shërbimet/përfitimet që ofrohen nga Bashkia në përfitim të fëmijëve dhe familjeve të identifikuar apo të referuara tek Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve.
3. Bashkia Shkodër do të lehtësojë me mjete dhe burime që ka në dispozicion, të gjitha aktivitetet sensibilizuese si dhe fushatat ndërgjegjësuese me fokus ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, objekt i kësaj marrëveshjeje.

## NENI VI

### Zbatimi i Marrëveshjes

Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qënë partnerë në zbatimin e saj dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tij.





## NENI VII

### Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme deri në dhjetor të 2019.

Palët mund të ndryshojnë ose të shtojnë në këtë Marrëveshje. Çdo ndryshim apo shtesë në këtë Marrëveshje bëhet vetëm me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

## NENI VIII

### Përfundimi i Marrëveshjes

Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje në rastet kur:

- a. Mbaron afati i kohëzgjatjes i përcaktuar në këtë marrëveshje.
- b. Shkelen dispozitat e ligjit dhe të marrëveshjes;
- c. Palët nuk i përmbahen qëllimit dhe objektit të marrëveshjes;
- d. Për forcë madhore

Për çdo rast, pavarësisht mënyrës së përfundimit, secila nga palët do të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja deri në çastin e ndërprerjes së marrëdhënieve.

## NENI IX

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim, me bisedime ndërmjet tyre, deri në gjetjen e një zgjidhje të përbashkët.

## NENI X

### Dispozita të fundit

Palët përgjigjen reciprocisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara deri në fund të marrëdhënieve të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, për të qenë partnere në zbatimin e saj, duke punuar së bashku për realizimin e veprimtarive.





Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga palët.

## NENI XI

### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PËR  
BASHKINË SHKODËR

KRYETAR  
Voltana Ademi



PËR  
SHOQATËN THE DOOR

DREJTOR EKZEKUTIV

Kastriot Faci

